



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL GJIROKASTER

Nr. _____prot.

Gjirokaster, më 05.03.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore ne Spitalin Rajonal Gjirokaster, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik ,ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi – Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore- 90524400-0

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori Ekonomik duhet të disponoje Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që te

përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03, ku procedura e asgjësimit të jetë sterilizim me Autoklavim ose teknologji ekuivalente.

2.1.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencë Profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011, ”Per mbrojtjen e mjedisit”, ligjit Nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme, ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, ”Per lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr.9010, date 13.2.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”, ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, ”Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” te ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, dt.18 shkurt 2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar te mbetjeve” ; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, date 26.05.2009, ”Per licensat dhe lejet, qe trajtohen nga/apo nepermjet QKB dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” e ndryshuar, Udhëzimin Kombëtar “Per Menaxhimin e Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore” dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** të fundit financiare. Vlera mesatare e xhiros së këtyre tre viteve duhet të jetë në masën 40% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor r

Argumentimi: Kriteri i mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së

xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e percaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,*

Përcaktimi i nga AK i kesaj kerkese, lidhet me natyren sensitive te sherbimit ne kontekst te shendetit publik dhe mjedisit, ndaj nga OE kerkohen parametra te larte besueshmerie. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor për besueshmerinë dhe qëndrueshmerinë e tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori duhet të ketë çertifikatën *ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”*, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.3 Operatori, duhet të ketë çertifikatën *ISO 14001:2015* mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno – Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e sterilizimit dhe incenerimit të lëshuar nga ISHSH (Inspektorati Shëndetësor Shtetëror).

Argumentimi: Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar dhe në VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në *Kreun IV, “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar”*, ku parashikohet shprehimisht: “.....10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke qenë se, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministarve Nr.798, datë 29.9.2010 për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore” AK si krijues i mbetjeve është përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijon, kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me landfill të licensuar për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Gjithashtu ky kriter vendoset në zbatim të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik nr.701 datë 22.07.2022 si dhe nr.751 datë 04.08.2022.

2.3.6 Operatori duhet te kete ne pronesi /qira, minimalisht 1 (nje) automjet;

Për automjet në pronësi: Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt-Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese. Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken 8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, " Per administrimin e mbetjeve spitalore"si edhe pike 9.3.3 te Udhezuesit Kombetar " Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore".

Për automjetet që nuk janë në pronësi: *Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt – Miratimet Higjenosanitare.* Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken 8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, "Administrimin e mbetjeve spitalore"si edhe pike 9.3.3 te Udhezuesit Kombetar "Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore
Argumentimi : Meqënëse shërbimi objekt kontrate, parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK, në ambientet e trajtimit të OE, dhe te produkti final nga ambientet e OE ne landfill, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion automjetet për të përmbushur elementet e kontratës (transportin), të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.7Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim dhe asgjесimin me incenerim të seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798, date 29.09.2010, per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm.

Ne rast te perdorimit te konteniereve njeperdorimsh, te paraqitet nje vetedeklarim ne te cilin te deklarohet se: kontenieret qe ofrohen nga OE, jane brenda standarteve ligjore te kerkuara ne fushen e mbetjeve te rezikshme spitalore.

Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri OE, duhet te paraqese:

-Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me

qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

-Impiantet per trajtimin me sterilizim dhe asgjесimin me incenerim, njekohehisht makineria për larjen

dhe dezinfektimin e kontenierëve duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B

ose të jenë pasqyruar në Lejet Mjedisore të paraqitura në përmbushje të kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 më

sipër;

--Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;

-Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ne baze te ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011, VKM Nr. 798 date 29.09.2010, ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002, VKM Nr. 99 date 18.02.2005, impiantet për realizimin e trajtimit me sterilizim dhe asgjесimit me incenerim te kategorive te caktuara te mbetjeve spitalore, jane pajisjet baze per realizimin me sukses te ketij sherbimi. Gjithashtu, AK, ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, ka parashikuar që në dallim nga kontenitoret per te mprehtat dhe qeset, që janë amballazhi i drejtpërdrejtë i mbetjeve spitalore që duhet të jenë njëpërdorimeshe, kontenitoret plastike te medhenj qe duhet te vihen ne dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues që shërbejnë për transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet te jene shumeperdorimesh dhe kjo nuk eshte nje zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore sic percaktohet nga Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 neni 6, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” nenet 7 dhe 33 si dhe ne edhe në Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM Nr. 798, date 29.09.2011.

Specifikimet teknike

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Mbetje te mprehta (instrumente të mprehta të përdorura, si për shembull: age, shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziera, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme) KODI 180101 dhe mbetje me potencial infektiv (tampone, fasho, pambuk të ndotur me gjak, tampone, fasho të ndotur me lengje trupore, qeset e gjakut për transfuzion, sistemet e kateterëve, pjesë trupi të padallueshme/mostra indesh, tuba dhe filtra dialize, pelena nga pacientë të infektuar, shiringa të ndotura me gjak, tuba të ndotur me gjak, ampula plastike të ndotura me gjak, doreza kirurgjikale të përdorura/maska/përparëse) KODI 180103 do te asgjесohen me autoklavim, sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
2. Mbetjet anatomike, (pjesë të trupit dhe organe, ose lengje te tilla si gjaku) KODI 180102 ,
3. Transporti i mbetjeve do te behet nga operatori me automjet duke respektuar standartin sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
“Kushtet qe duhet te respektoje transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”
4. Operatori duhet te siguroje ambalazhin perkates sipas specifikimeve te caktuara ne Udhëzuesin Kombëtar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore. Furnizimi me amballazh 1(nje) perdorimesh (kontenitore kartoni me qese te verdhe dhe kontenitore plastik me kapak) do te behet cdo jave ose edhe me shpesh sipas kerkeses se AK.
5. Operatori duhet te instaloje nje frigorifer (banak frigoriferik) ne ambjentet e SRGJ-se me nje kapacitet me te madh se 200 litra dhe temperature -18°C per ruajtjen e mbetjeve te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportit me mjetet e tij per ne impiantin e trajtimit. Pas marrjes se mbetjeve, operatori do te disinjektoje frigoriferin dhe ambjentin perreth, si dhe do

te beje mirembajtjen e frigoriferit.

6. Operatori ekonomik duhet te sjelle ne perdorim 6 (gjashtë) peshore elektrike mbi 100 kg, nje qe

sherben per te peshuar mbetjet e krijuara ne pavion dhe nje per te peshuar mbetjet qe do ti dorezohen operatorit ekonomik. Peshoret duhet te jene te kolauduar.

7. Mbetjet e mbledhura ne kontenitoret perkates do te peshohen ne prani te dy paleve duke u zbritur pesha e ambalazhit.

8. Operatori dhe Perfaqesuesit e SRMF per cdo dorezim mbetjesh tek operatori per asgjesisim, do te mbajne "Dokumentin e Dorezimit te Mbetjeve te Rrezikshme", sipas VKM 371, Date 11.06.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre".

9. OE bashke me dokumentin e dorezimit do te ktheje ne Spital konfirmimin me shkrim se ka trajtuar/asgjësuar mbetjet spitalore sipas kerkesave te kontrates dhe do te bashkangjise te gjithë shiritat e punes (kopje) te autoklaves/ inceneratorit per sasine e mbetjeve te terhequra nga Spitali. OE do te dorezoje cdo 3-muaj flete – analize nga laborator i akredituar te produktit perfundimtar te autoklaves dhe hirit te inceneratorit ku te tregohet cilesia e sherbimit sipas kerkesave te VKM 798 date 29.09.2010.

Kerkesat që duhet të përmbushin enët e mbetjeve spitalore. .

Të përgjithshme .

Enët për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet:

- të mos lejojnë rrjedhjen, të jenë të papërshkueshëm ndaj lagështirës dhe të fortë për të parandaluar grisjen, çarjen apo shpimin në kushte normale përdorimi.

- të mos ripërdoren nëse janë një-përdorimshe dhe të pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo përdorimi nëse janë disa-përdorimshe.

- të mund të mbyllen në një mënyrë që të parandalohet derdhja e mbetjeve spitalore gjatë transportit.

- të jenë në gjendje të mirë dhe të pa ndotur, të padëmtuar ose ndonjë defekt tjetër që mund të dëmtojë përdorimin e tyre të sigurt.

Llojet e konteinerëve dhe kodi i ngjyrave

Mbetjet spitalore duhet të vendosen në enët e mbetjeve spitalore sipas rryma përkatëse si më poshtë: Për mbetjet infektive: qese/kosha/konteinerë të posacëm ngjyrë e verdhë;

Për mbetjet patologjike: qese ngjyrë kafe;

Për mbetjet kimike, farmaceutike: kuti të kyçura farmaceutike/konteinerë të posaçëm ngjyrë e kuqe;

Për mbetjet e parrezikshme: qese ngjyrë e zezë; Për mbetjet e parrezikshme të riciklueshme: qese ngjyrë jeshile.

Specifikimet e enëve të ambalazhimit të mbetjeve spitalore

1. Kutit për të mprehtat

Të jenë në përputhje me standardin Britanik BS 7320:1990 në lidhje me rezistencën ndaj depërtimit dhe rezistencën ndaj rrjedhjes pas rënies vertikale dhe përmbysjes ose specifikime të ngjashme për konteinerët e të mprehtave;

Hapja duhet të jetë aq e gjerë sa të lejojë materialet e asgjësueshme të hidhen në konteiner duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e materialit të asgjësueshëm për të cilën është projektuar konteineri i posaçëm, hapja duhet, në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;

- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, ato duhet të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në konteiner;
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e konteinerëve duhet të mos lejojnë rrjedhje;
- Kur është e mundur, të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të ndezshme dhe të afta për t'u djegur në mënyrë të sigurt dhe nuk duhet të përbëhet nga polivinilkloridi (PVC); 11
- Kur është e mundur, të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të tilla që në to të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. Të etiketohen qartë me fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe duhet të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastikë

- Të tillë që të mbyllen;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe korrozionit;
- Të tillë që në to të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa.

ETIKETIMI I ENËVE TË MBETJEVE SPITALORE

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila duhet të përmbajë shenjën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuara në Pjesën A dhe specifikimet në Pjesën B, si dhe përmbajtjen sipas Pjesës C të kësaj Shtojce. Etiketa duhet të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse, ose të jetë e para-printuar në një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

Tipi i enës së mbetjeve spitalore

Për të mprehtat Përmasat e simbolit

- me kapacitet prej më pak se 2 litra jo më pak se 40 mm x 40 mm
- me kapacitet prej 2 litra ose më shumë jo më pak se 75 mm x 75 mm
- konteinerë të tjerë jo më pak se 150 mm x 150 mm

Specifikimet e simbolit:

Ngjyrat e simbolit duhet të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e konteinerit

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë



Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë

Etiketa përfshin shenjën ndërkombëtare dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore, njoftimin e rrezikut mjekësor në shqip dhe në anglisht dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6). Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

*Duke u bazuar në shkresën e ardhur nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, kodet që marrin mbetjet

spitalore pas trajtimit me incenerim dhe autoklavim , jane mbetjet me kod 19 “ Mbetje nga impiantet e trajtimit te mbetjeve nga impiantet e trajtimit te ujrave te ndotura off-site (jo ne vend)

dhe nga pergatitja e ujit te pijshem dhe ujit per perdorim industrial “ specifikesht:

19 01 Mbetje nga iceneratoret ose piroliza e mbetjeve

19 03 Mbetje te stabilizuara te ngurtesuara.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose

burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të

favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të

jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”

NJËSIA E PROKURIMIT